



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 120

Tiranë – E martë, 28 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 454, datë 20.6.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për shpërblimin e Ekipit Kombëtar të Futbollit 8363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 460, datë 22.6.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”..... 8363
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 461, datë 22.6.2016	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme..... 8364
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 462, datë 22.6.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 561, datë 16.8.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8364
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 22.6.2016	Për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Koplik, Malësi e Madhe..... 8365
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 464, datë 22.6.2016	Për krijimin e fondit në mbështetje të mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike..... 8367
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 465, datë 22.6.2016	Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale..... 8369
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 468, datë 22.6.2016	Për rishpërndarje fondesh buxhetore për shpenzime korrente, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë..... 8373
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 469, datë 22.6.2016	Për shpalljen e liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna si zonë bashkë-menaxhuese peshkimi..... 8373

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 23.6.2016	Për disa shtesa në vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, të Këshillit të Ministrave, “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, të ndryshuar.....	8374
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministrit të Financave nr. 3078, datë 14.6.2016	Për ndryshimin e udhëzimit të përbashkët nr. 1568/3, datë 14.4.2015, “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve portuale në autoritetin portual Durrës për vitin 2015”.....	8374
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 3491, datë 21.6.2016	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe kthimi në identitet i godinës së Prefekturës së Qarkut Tiranë”	8375

**VENDIM**

Nr. 454, datë 20.6.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE
SPORTIT, PËR SHPËRBLIMIN E EKIPIT
KOMBËTAR TË FUTBOLLIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2016, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) eurosh, për shpërblimin e Ekipit Kombëtar të Futbollit.

2. Kundërvlehtë në lekë e këtij fondi t’i akordohet në formën e transfertës Federatës Shqiptare të Futbollit për t’u përdorur sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Efektet financiare, sipas pikës 1, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit miratuar për vitin 2016.

4. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 460, datë 22.6.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 953, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR DISPOZITAT
ZBATUESE TË LIGJIT NR. 92/2014, “PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 159, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi

vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 10, i vendimit nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 10

**Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për
qëllim të rimbursimit të TVSH-së**

1. Për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, kategoritë e eksportuesve në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;

b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;

c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;

ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2. Personat e tatueshëm, që plotësojnë kriteret sipas pikës 1, të këtij neni, rimbursohen automatikisht brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, si persona me risk zero.

3. Personat e tatueshëm, vlera e eksporteve të të cilëve, të kryera në periudhën/at tatimore për të cilën/at kërkohet rimbursim, përbën më shumë se 50% deri në 70% të vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet, rimbursohen brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim të TVSH-së, duke iu nënshtruar më parë procedurës së analizës së riskut.

Nëse nga analiza e riskut rezulton se personi i tatueshëm që klasifikohet në këtë kategori duhet t’i nënshtruar procesit të kontrollit tatimor, e gjithë procedura, përfshirë kontrollin, përfundon brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në të kundërt, brenda afatit 30-ditor nga data e paraqitjes



së kërkesës për rimbursim kryhet rimbursimi i TVSH-së nëpërmjet sistemit të thesarit.

4. Të gjithë personat e tjerë të tatueshëm që kryejnë eksporte, por nuk klasifikohen në pikat 1 dhe 3, të këtij neni, rimbursohen brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për rimbursim duke iu nënshtruar procedurës së analizës së riskut.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 461, datë 22.6.2016

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR
PËR PROKURORINË E PËRGJITHSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Prokurorinë e Përgjithshme, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, zëri “Shpenzime kapitale”, të shtohet fondi prej 5 100 000 (pesë milionë e njëqind mijë) lekësh, për ngritjen e sistemit elektronik për administrimin e kërkesave për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 462, datë 22.6.2016

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 561, DATË 16.8.2006, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT SIPAS
GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË
DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 34, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë”, bashkëlidhur vendimit nr. 561, datë 16.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2016, në buxhetin e Gardës së Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 qershor 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Lidhja nr. 1

PAGA BAZË PËR GRADË PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficerë	Madhor	Gjeneral garde	115000
	I lartë	Kolonel	103000
		Nënkolonel	91000
		Major	78300
	I mesëm	Kapiten	67000
		Nënkapiten	63500
	I ulët	Toger	60250
Nëntoger		57000	
Për punonjësit nënoficerë	Madhor	Kryekapter	48500
	I lartë	Kapter	46100
		Kapter Shtabi	45000
		Kapter mjeshtrë	44000
	I mesëm	Kapter i parë	43500
		Kapter i dytë	43000
		Kapter i tretë	42500
	I ulët	Kapter i katërt	41700
		Rreshter	40500

VENDIM

Nr. 463, datë 22.6.2016

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË
TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT
EKONOMIK NË KOPLIK, MALËSI E
MADHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9789, datë 19.7.2007, “Për krijimin dhe funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” të territorit me sipërfaqe 61 (gjashtëdhjetë e një) ha, pjesë e zonës kadastrale nr. 2220, në Koplík, Malësi e Madhe, të përbërë nga parcelat me numrat e pasurive dhe sipërfaqet përkatëse, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtrirja, kufijtë, pikat e hyrjes dhe të daljes së kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Veprimtaritë që do të zhvillohen në këtë zonë janë të llojit:

- prodhuese, industriale dhe agropërpunimi;
- tregtare dhe magazinimi mallrash;
- shërbime.

4. Periudha e funksionimit të zonës është deri në 99 vjet.

5. Zona e teknologjisë dhe e zhvillimit ekonomik jepet me qira, me çmimin 1 euro.

6. Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës të bëhet nëpërmjet procedurës konkurruese.

7. Kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohen zhvilluesit, janë:

- propozimi i projektit teknik;
- ndikimi mjedisor;
- ndikimi social;
- kohëzgjatja e punimeve;
- kapaciteti financiar i kompanisë dhe mundësia e financimit të projektit.

8. Vendimi nr. 12, datë 4.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës ekonomike në Koplík, Shkodër”, dhe vendimi nr. 773, datë 4.6.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien e statusit të zhvilluesit të zonës ekonomike në Koplík, Shkodër, dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhjeje



dhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë”, shfuqizohen.

9. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË “ZONËN E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”, KOPLIK, MALËSI E MADHE

Nr.	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Statusi i pronësisë
1	2220	201/8	Arë	985	Shtet
2	2220	193	Arë	27,573	Shtet
3	2220	194	Arë	20,978	Shtet
4	2220	163	Arë	30,382	Shtet
5	2220	160	Arë	63,199	Shtet
6	2220	161	Arë	86,998	Shtet
7	2220	159	Arë	24,004	Shtet
8	2220	200	Arë	86,417	Shtet
9	2220	195/1	Kullotë	49,321	Shtet
10	2220	157	Arë	19,882	Shtet
11	2220	158/1	Arë	19,124	Shtet
12	2220	187/2	Arë	55,941	Shtet
13	2220	185/4	Kullotë	99,231	Shtet
14	2220	192	Arë	22,000	Shtet
15	2220	201/9	Arë	4,004	Shtet
				610,039	SHUMA

**HARTA E “ZONËS SË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK”
KOPLIK, MALËSI E MADHE, SIPËRFAQJA 61 HA**





VENDIM
Nr. 464, datë 22.6.2016

**PËR KRIJIMIN E FONDIT NË
MBËSHETJE TË
MIKRONDËRMARRJEVE,
NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË
MESME QË USHTROJNË AKTIVITET
NË ZONAT TURISTIKE/HISTORIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar, të neneve 8 e 8/1, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, të neneve 5 e 7, të ligjit nr. 10303, datë 15.7.2010, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Fondit në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike, më poshtë “Fondi”, me vlerë të përgjithshme 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekë, për një kohëzgjatje zbatimi 3-vjeçare, për periudhën 2016–2018. Fondi fillon të zbatohet në vitin 2016 me këtë shtrirje kohore dhe sipas vlerave të mëposhtme:

- a) për vitin 2016, vlera e fondit të jetë 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekë.
- b) për vitin 2017, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
- c) për vitin 2018, vlera e fondit të jetë 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

2. Fondi, përveç fondeve nga buxheti i shtetit, i parashikuar në pikën 1, mund të ketë si burim financimi edhe donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare. Në këtë rast, procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në marrëveshjen që do të lidhet me donatorin apo institucionin financiar e cila miratohet bashkërisht nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe përfaqësuesi i donatorit apo i përfaqësuesit të institucionit financiar.

3. Fondi u jep ndihmë, në formë granti të drejtpërdrejtë, mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet bashkë-financimit. Në varësi të vlerësimit për projektin e dorëzuar nga aplikanti/tët, Fondi mbulon deri në 50% të kostove të pranueshme, por jo më shumë se 3 000 000 (tre milionë) lekë.

4. Përfitimi i ndërmarrjeve për të njëjtin projekt nga mbështetja e programeve apo projekteve, duke përdorur fonde nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, nuk përbën pengesë për përfitim edhe nga Fondi në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike. Në këtë rast, Fondi do të mbulojë vetëm 30% të kostove.

5. Objektivi kryesor i Fondit është stimulimi i mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që ushtrojnë aktivitet në zonat turistike/historike, për t’iu mundësuar atyre mbështetje financiare për investime kapitale në ambientet e ushtrimit të aktivitetit.

6. Qëllimi i Fondit është rivitalizimi ekonomik në zonat turistike/historike.

7. Kostot e pranueshme, që mund të bashkë-financohen, përfshijnë kostot, për:

- a) rikonstrukcion të ambienteve të brendshme të vendit të ushtrimit të aktivitetit;
- b) blerje makinerish/pajisjesh;
- c) shërbime këshillimore për projektimin për ristrukturimin dhe modernizimin e ambienteve të punës.

8. Përfitojnë nga Fondi ndërmarrjet që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) janë biznese të klasifikuara, si mikro, të vogla apo të mesme, sipas ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar;
- b) kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) ushtrojnë aktivitetin e tyre në një nga zonat turistike/historike;
- ç) kanë një kontratë qiraje të paktën dyvjeçare për ambientet ku ushtrohet aktiviteti;
- d) janë të regjistruara në QKB dhe nuk kanë detyrime tatimore e doganore të papaguara;
- dh) nuk janë në proces falimentimi ose procedurë likuidimi;
- e) Plotësojnë kriteret e legjislacionit të ndihmës shtetërore për ndihmën “*De minimis*”;



ë) Duhet të jenë të afta për të financuar jo më pak se 50% të vlerës së projektit.

9. Procedura e aplikimit për këtë fond është si më poshtë vijon:

a) Aplikimi paraqitet në sportelin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) nga vetë kërkuuesi apo çdo person i autorizuar prej tij sipas formatit të aplikimit, të miratuar nga drejtori ekzekutiv i AIDA-s. Aplikanti, së bashku me formularin e aplikimit, duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

- aktin e regjistrimit të subjektit sipas legjislacionit në fuqi (QKB);

- pasqyrat financiare të vitit të fundit të ndërmarrjes. Në rastet kur bilanci është negativ, ndërmarrja duhet të dorëzojë një vërtetim bankar që vërteton se ndërmarrja ka në llogari bankare një shumë të barabartë me buxhetin e projektit;

- buxhetin e projektit, së bashku me një vërtetim bankar që vërteton se mbulon në masën 50% vlerën e projektit;

- planin e biznesit;

- dokumentin që vërteton se janë paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni doganor dhe tatimor;

- kontratën e qirasë të paktën me një afat dyvjeçar për ambientet ku ushtrohet aktiviteti;

- dokumentin e identifikimit, të njohur nga ligji, të personit që paraqet kërkesën në emër të subjektit;

- autorizimin që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, kur ky nuk është titullari i subjektit, është i autorizuar prej këtij subjekti për të aplikuar dhe për të bërë deklaratimet e kërkuara në emër të subjektit.

b) Punonjësi i AIDA-s asiston të interesuarin në plotësimin e formularit të aplikimit, verifikon identitetin dhe kërkon nënshkrimin e formularit të plotësuar.

c) Dokumentet paraqiten në origjinal, në kopje me të njëjtën fuqi provuese me origjinalin ose në kopje të panjësuar me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit.

ç) Kur kërkesa paraqitet nga personi i autorizuar, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, bashkë me dokumentet paraqitet edhe dokumenti që vërteton faktin e të qenit i autorizuar.

d) Aplikimi pajiset me një numër aplikimi dhe regjistrohet në Regjistrin e Skemës së Grantit për Ndarje të Kostove.

dh) Aplikimet shqyrtohen nga Komisioni i Aprovimit të Grantit, i cili përbëhet nga drejtori ekzekutiv i AIDA-s, që është njëkohësisht edhe kryetar i këtij Komisioni, 2 anëtarë të emëruar nga drejtori ekzekutiv i AIDA-s dhe 2 anëtarë të caktuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

e) Vendimi për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazohet vetëm mbi dokumentet e paraqitura.

ë) Vendimi për akordim të grantit merret me shumicë votash dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët prezentë të Komisionit.

f) Pas njoftimit, ndërmarrja, së cilës i është miratuar kërkesa, paraqitet pranë AIDA-s për të nënshkruar marrëveshjen kontraktuale për dhënien e grantit sipas formatit të miratuar nga drejtori ekzekutiv i AIDA-s, në të cilën do të përcaktohet dhe afati për përfundimin e projektit.

Procedurat e hollësishme të aplikimit, të disbursimit, si dhe mënyra e menaxhimit të fondit përcaktohen në rregulloren e funksionimit të fondit, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë.

Kjo pikë nuk zbatohet në rastin ku përveç fondeve nga buxheti i shtetit, të parashikuara në pikën 1, të këtij vendimi, fondi ka si burim financimi donatorë të ndryshëm apo institucione financiare ndërkombëtare.

10. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për menaxhimin e Fondit në Mbështetje të Mikrondërmarrjeve, Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, që ushtrojnë aktivitetet në zonat e mbrojtura turistike. Përfundimisht për vitin 2016, autorizohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për të lidhur marrëveshje mirëkuptimi me AADF-në (Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim) për mbështetjen e sipërmarrjeve që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në pazarin e Korçës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen si më poshtë vijon:

- 29 000 000 (njëzet e nëntë milionë) lekë, nga fondet e planifikuara për AIDA-n, për vitin 2016;

- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë të planifikohen në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, për vitet 2017 dhe 2018, e cila krijon



një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s.

12. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 465, datë 22.6.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE RREGULLAVE PËR KALIMIN E SË
DREJTËS SË PRONËSISË MBI
PARCELËN NDËRTIMORE TË
OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. E drejta e pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit të legalizuar transferohet nëpërmjet aktit administrativ (vendim i Këshillit të Ministrave), sipas përcaktimeve të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

2. Kur parcela e ndërtimit të legalizuar shtrihet mbi pasuri të paluajtshme në pronësi private, të subjekteve joposuese të ndërtimit, nëpërmjet të njëjtut akt administrativ miratohet masa dhe vlera e kompensimit financiar për sipërfaqet takuese, pronë private, që preken nga ndërtimi.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit për sipërfaqet, pronë private, që preken nga ndërtimet e legalizuara, është i vlefshëm për regjistrimin përfundimtar të parcelës ndërtimore në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

II. PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE MIRATIMIT TË MASËS E VLERËS SË KOMPENSIMIT

4. Propozimi për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit financiar përgatitet nga drejtoritë e ALUIZNI-t, pranë ministrisë përgjegjëse për zhvillimin urban, pas miratimit të lejes së legalizimit. Paraqitja skematike e të dhënave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe kompensimin financiar përcaktohet me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të ALUIZNI-t.

5. Në hartimin e propozimit drejtoritë e ALUIZNI-t bazohen në dokumentacionin teknik (genplan) dhe në informacionin mbi gjendjen juridike të pronës, pavarësisht nga lloji i pasurisë.

Përcaktimet e këtij vendimi, në asnjë rast, nuk cenojnë të drejtën e pronarit joposues të truallit për kompensim, sipas nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Nëse pas përfundimit të procedurave, sipas këtij vendimi, ka pretendime pronësie të mbështetura mbi tituj të paregjistruar dhe më të hershëm, atëherë ZVRPP-ja i kërkon ALUIZNI-t hartimin e propozimeve për procedurat e kompensimit të pronarit joposues.

6. Procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe miratimit të masës e vlerës së kompensimit financiar zbatohen pavarësisht se parcela ndërtimore u përket anëtarëve të familjes të poseduesit të ndërtimit të legalizuar apo personave me të cilët ai ka lidhje fisnore/gjinore. Bën përjashtim rasti kur pasuria përfshihet në bashkësinë ligjore të poseduesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

7. Nëse poseduesi është bashkëpronar në pasurinë ku ndodhet ndërtimi i legalizuar, për rregullimin e pronësisë në parcelën ndërtimore zbatohen këto rregulla:

a) Kur pjesët takuese ideale të bashkëpronësisë janë të papërcaktuara, ato prezumohen të barabarta (në përpjesëtim me numrin e të gjithë bashkëpronarëve);

b) Pjesa takuese ideale e poseduesit llogaritet në sipërfaqen e parcelës ndërtimore. Nëse, pas kësaj, nuk plotësohet sipërfaqja e parcelës ndërtimore, për sipërfaqen e mbetur të saj kryhet kalimi i pronësisë në favor të poseduesit, si dhe kompensimi i bashkëpronarëve të tjerë, sipas pjesëve të tyre ideale;

c) Mosmarrëveshjet për ndarjen e parcelës dhe për masat e pjesëve takuese zgjidhen nga gjykata.



8. Nëse një nga bashkëposeduesit e ndërtimit të legalizuar është pronar i vetëm i pasurisë ku ndodhet parcela, krijohet bashkëpronësia mbi parcelën ndërtimore, duke u transferuar poseduesve të tjerë pjesët takuese (ideale), të parcelës. Nëpërmjet të njëjtit vendim të Këshillit të Ministrave miratohet edhe masa e vlera e kompensimit financiar për këto pjesë takuese.

I njëjti parim zbatohet edhe kur pronarë të pasurisë janë disa nga bashkëposeduesit e ndërtimit.

9. Për rastet e parashikuara në pikat 6, 7 dhe 8, të këtij vendimi, palët mund të realizojnë, paraprakisht, marrëveshje civile për rregullimin e raporteve të pronësisë në parcelën ndërtimore, të cilën duhet ta dorëzojnë pranë drejtorisë së varësisë së ALUIZNI-t ose ZVRPP-së, brenda 60 ditëve nga data e miratimit të lejes së legalizimit. Në të kundërt, vijohet me procedurat sipas pikave 6, 7 dhe 8 të vendimit.

10. Kur parcela e ndërtimit të legalizuar shtrihet mbi pasuri të paluajtshme, e cila, sipas informacionit mbi gjendjen juridike, rezulton “pronar i pavërtetuar” (PPV), procedurat e kalimit të pronësisë vijojnë në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, si për pasuritë “shtet”.

11. Për shtesat anësore në tejkalim të lejes së ndërtimit, të miratuar nga autoriteti përgjegjës, procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe miratimit të masës e vlerës së kompensimit financiar zbatohen vetëm kur tejkalohej gjurma e sheshit të ndërtimit, përcaktuar në dokumentacionin e lejes përkatëse.

12. Hipotekat që rëndojnë mbi parcelën ndërtimore nuk pengojnë kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit financiar. Kreditori hipotekar ka të drejtë garancie mbi shumën e kompensimit financiar. E drejta e garancisë pasqyrohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, në një seksion të veçantë, për efekt të zbatimit të vendimit nga ATP-ja. ATP-ja detyrohet të caktojë shumën e kompensimit financiar në një llogari bankare të posaçme. Kjo shumë nuk mund të vendoset në dispozicion të subjektit përfitues ose të tretëve pa miratimin apo marrëveshjen e kreditorit.

13. Kur ndërtimi i legalizuar është ngritur mbi pasurinë në pronësi të të tretëve, i sekuestruar sipas nenit 560, të Kodit të Procedurës Civile, ALUIZNI-i njofton përmbaruesin gjyqësor për të

vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm mbi shumën e kompensimit financiar, sipas pjesës IV, të titullit II, të kreut IV, të këtij Kodi.

Procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe kompensimit financiar vazhdojnë pas konfirmimit, brenda 30 ditëve, nga përmbaruesi.

Në seksionin e veçantë të vendimit të Këshillit të Ministrave pasqyrohen shënimet për ekzekutimin e detyrueshëm mbi shumën e kompensimit financiar. Agjencia e Trajtimit të Pronës detyrohet të caktojë këtë shumë në një llogari bankare të posaçme dhe ajo nuk mund të vendoset në dispozicion të subjektit përfitues (debitorit) pa përfunduar procedura e ekzekutimit të detyrueshëm.

Nëse përmbaruesi nuk konfirmon brenda 30 ditëve apo pretendon pezullimin e procedurave të kalimit të pronësisë dhe kompensimit, drejtoria e ALUIZNI-t njofton ministrin e Drejtësisë për nisjen e procedimit disiplinor.

14. Në rastin e të drejtave të tjera të të tretëve (qira, enfitozë, uzufukt etj.) zbatohen të njëjtat rregulla si ato të pikës 12, të këtij vendimi.

15. Kur ka kufizim mbi pasurinë, sipas neneve 59 dhe 75, pika 2, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, për arsye që lidhen me vlefshmërinë e titullit të pronësisë, shuma e kompensimit financiar vendoset nga Agjencia e Trajtimit të Pronës në një llogari bankare të posaçme dhe nuk mund të disponohet nga subjekti përfitues pa zgjidhjen e shkakut të kufizimit në rrugë gjyqësore. Në këto raste, kufizimi pasqyrohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, në një seksion të veçantë, për efekt të zbatimit të vendimit nga Agjencia e Trajtimit të Pronës.

Pavarësisht sa më sipër, kufizimet, në asnjë rast, nuk pengojnë kalimin e së drejtës së pronësisë dhe miratimin e masës e vlerës së kompensimit financiar.

16. Situata e mbivendosjes së titujve nuk pengon procedurat, sipas këtij vendimi. Mbivendosja në parcelën ndërtimore shuhet me hyrjen në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton kalimin e së drejtës së pronësisë dhe vlerën e masën e kompensimit financiar. Në këto raste, kompensimi financiar miratohet pa përcaktuar subjektin përfitues të tij, duke pasqyruar faktin e mbivendosjes së titujve në seksionin e veçantë të vendimit të Këshillit të Ministrave.



Për zbatimin e kësaj pike, Agjencia e Trajtimit të Pronës detyrohet të caktojë, në një llogari bankare të posaçme, shumën e miratuar të kompensimit financiar. Ajo do të vendoset në dispozicion të subjektit që do të rezultojë përfitues pasi të jetë zgjidhur, në rrugë gjyqësore, mosmarrëveshja për të drejtat mbi këtë shumë mes zotëruesve të titujve që krijonin mbivendosje.

17. Për parcelat e ndërtimeve të legalizuara, të cilat janë brenda territoreve apo objekteve ish-ushtarake, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, ALUIZNI-i, përpara se të nisë procedurat e kalimit të pronësisë, i paraqet kërkesë për procedim ministrit të Mbrojtjes. Në mbështetje të kësaj kërkesë, kur territoret nuk do t'u mbeten Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes, brenda 30 ditëve, nis procedurat për pasqyrimin e ndryshimeve në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit dhe/ose ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit.

Për territoret apo objektet ish-ushtarake që nuk janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, ose për territore të tjera në përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore, projektvendimi i Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë i përcillet për bashkërendim këtyre institucioneve. Përcaktimet për ndryshimin/shuarjen e përgjegjësisë së administrimit pasqyrohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, në një seksion të veçantë. Në zbatim të vendimit individual, kryhen ndryshimet përkatëse në inventarin e pronave të paluajtshme të shtetit.

18. Procedurat për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën e objektit të legalizuar, sipas këtij vendimi, zbatohen edhe për rastet, kur:

a) ndërtimi i legalizuar gjendet brenda apo në lidhje funksionale me sipërfaqen e oborrit në përdorim, sipas vendimit nr. 578, datë 29.8.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, të ndryshuar;

b) ndërtimi i legalizuar gjendet brenda apo në lidhje funksionale me truallin e objekteve të ngritura para datës 10.8.1991, për të cilat nuk zotërohen akte të fitimit të pronësisë, sipas vendimit nr. 608, datë 5.9.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si

dhe për regjistrimin e tyre”, të ndryshuar.

Në këto raste, çmimi i parcelës ndërtimore, mënyrat dhe rregullat e tjera të pagesës zbatohen sipas legjislacionit për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

19. Kërkesa për miratim nga bashkia kompetente, sipas pikës 2, të nenit 15/1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, paraqitet nga drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t, përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për kalimin e së drejtës së pronësisë dhe masës e vlerës së kompensimit financiar. Kjo kërkesë paraqitet për të gjitha parcelat ndërtimore në pasuritë e transferuara në pronësi të bashkisë, brenda territorit të njësisë administrative përbërëse.

Kërkesa merret në shqyrtim nga këshilli bashkiak, i cili duhet të vendosë për miratimin e tjetërsimit, duke nxjerrë pasuritë (ose pjesë të tyre) nga inventari i pronave të bashkisë.

Kur bashkia ka vetëm të drejta administrimi mbi pasurinë, ajo njoftohet për faktin e kalimit të pronësisë përpara miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, me qëllim nxjerrjen e pasurisë (ose pjesës së saj) nga inventari i pronave të bashkisë.

20. Nuk i nënshtrohen kalimit të së drejtës së pronësisë parcelat e ndërtimeve të legalizuara që “disponohen sipas një akti të ligjshëm, të paregjistruar”, në përputhje me përcaktimet e nenit 16, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

21. Nëse konsolat (volumet ndërtimore të mbështetura vetëm në një krah) projektohen në trotuare, këto sipërfaqe nuk u nënshtrohen procedurave të kalimit të pronësisë.

22. Për ndërtimet e llojit “shtesë në lartësi”, në pallate të regjistruara, kur poseduesi i shtesës nuk është pronar i njësisë ndërtimore në objektin ekzistues, kryhet kalimi i së drejtës së pronësisë për pjesën takuese ideale që i transferohet poseduesit, në hapësirën e përbashkët (në bashkëpronësi të detyrueshme) dhe kompensimi i banorëve të tjerë, sipas procedurave të këtij vendimi.

Pas miratimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, ZVRPP-ja zbaton përcaktimet e pikës 25, të vendimit nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së dhe të procedurave



apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara”.

III. RREGULLIM I POSAÇËM PËR VENDIMET E MIRATUARA TË KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË/KOMPENSIMIT FINANCIAR DHE DISPOZITA TË FUNDIT

23. Për vendimet e Këshillit të Ministrave, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kalimi i së drejtës së pronësisë është i vlefshëm, pa qenë nevoja për lidhjen e kontratës. Kur leja e legalizimit nuk është nxjerrë ende, procedurat e kalimit të pronësisë konsiderohen të përfunduara në momentin e miratimit të lejes.

Masa përfundimtare e parcelës, për të cilën fitohet dhe regjistrohet titulli i pronësisë, është ajo e përcaktuar në lejen e legalizimit, sipas genplanit shoqëruar.

24. Kur të drejtat mbi ndërtimin informal janë transferuar më parë, nëpërmjet veprimeve juridiko-civile, të realizuara pas miratimit të kalimit të së drejtës së pronësisë, drejtoritë e varësisë së ALUIZNI-t përgatitin propozimet e ndryshimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, përpara se të legalizohet ndërtimi.

25. Vendimet e Këshillit të Ministrave, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 50/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar”, që kanë transferuar të drejtën e pronësisë mbi parcelën ndërtimore, nuk rishikohen, për efekt të zbatimit të kufizimeve mbi sipërfaqen, sipas pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar.

26. Kur është i nevojshëm ndryshimi i vendimeve të Këshillit të Ministrave, që kanë të përcaktuar masën dhe vlerën e kompensimit financiar, zbatohen këto rregulla:

a) Në rastin e zvogëlimit të sipërfaqes për kompensim, të korigjimit të listës emërore të bashkëpronareve dhe të numrave të pasurisë apo zonës kadastrale, çmimi që do të përdoret për llogaritjen e vlerës së kompensimit financiar do të jetë ai i përdorur në vendimin fillestar të Këshillit të Ministrave;

b) Në rastin e zmadhimit të masës (sipërfaqes) së kompensimit për të njëjtën pasuri, çmimi që do të përdoret, për pjesën e sipërfaqes shtesë, do të

jetë ai i përcaktuar në bazë të vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në fuqi në momentin e ndryshimit.

27. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për parcelat ndërtimore që ndodhen në toka bujqësore, të fituara nëpërmjet akteve të marrjes së tokës në pronësi (AMTP), ALUIZNI do të kryejë procedurat e kalimit të së drejtës së pronësisë dhe të miratimit të masës e vlerës së kompensimit financiar pasi të jenë zbatuar parashikimet e vendimit nr. 994, datë 9.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi”, të ndryshuar, nëse është rasti.

Kur AMTP-ja figuron e regjistruar, pas paraqitjes nga ALUIZNI të kërkesës për informacion mbi gjendjen juridike, ZVRPP-ja detyrohet të nisë menjëherë procedurat e parashikuara në vendimin e sipërpërmendur, për verifikimin e titullit të pronësisë mbi tokën bujqësore, nëse ky verifikim nuk është kryer më parë.

28. Për parcelat ndërtimore që shtrihen në prona të të tretëve, për të cilat është miratuar kalimi i së drejtës së pronësisë, ALUIZNI, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përgatit propozimet për miratimin e masës dhe vlerës së kompensimit financiar të pronarëve joposedues, pasi të jetë miratuar leja e legalizimit në favor të poseduesve të ndërtimeve informale.

29. Në çdo rast, deri në përfundimin e procedurave të kalimit të së drejtës së pronësisë dhe/ose kompensimit të pronarëve joposedues apo rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë mbi parcelën ndërtimore në rrugë juridiko-civile apo gjyqësore, ndërtimi i legalizuar qëndron i regjistruar sipas pikës 14, të vendimit nr. 1095, datë 28.12.2015, të Këshillit të Ministrave.

30. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencia e Trajtimit të Pronës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 15 korrik 2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 468, datë 22.6.2016**

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH
BUXHETORE PËR SHPENZIME
KORRENTE, NDËRMJET PROGRAMEVE
BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2016,
MIRATUAR PËR MINISTRINË E
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve për shpenzime korrente, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Programit “Përkujdesja sociale”, tit. 10430, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera (për pajisjen me dekoder, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480/2015 dhe specifikimeve teknike të vendimit nr. 38/2015 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, të familjeve në nevojë, përfituese nga skema e ndihmës ekonomike)”, t’i shtohet fondi prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekësh;

b) Programit “Tregu i punës”, tit. 10550, kap. 1, art. 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i pakësohet fondi prej 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekësh;

c) Programit “Tregu i punës”, tit. 10550, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh;

ç) Programit “Përfshirja sociale”, tit. 10460, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;

d) Programit “Arsimi i mesëm profesional”, tit. 09240, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Edi Rama**VENDIM****Nr. 469, datë 22.6.2016**

**PËR SHPALLJEN E LIQENIT TË
SHKODRËS DHE LUMIT BUNA SI ZONË
BASHKËMENAXHUESE PESHKIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 54, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e liqenit të Shkodrës dhe të lumit Buna, nga grykëderdhja deri në pikën e bashkimit me liqenin e Shkodrës, si zonë bashkëmenaxhuese peshkimi, duke pasur parasysh statusin si zonë natyrore veçanërisht e mbrojtur dhe si habitat i shpendëve ujorë, të përfshirë në listën e Konventës Ramsar, për të ushtruar aktivitetin e peshkimit tradicional.

2. Plani i bashkëmenaxhimit për zonën e liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna miratohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, brenda 12 muajve nga data e miratimit të kësaj zone.

3. Plani i bashkëmenaxhimit, sipas pikës 2, të jetë në përputhje me planin e menaxhimit të basenit Drin-Buna.

4. Veprimtaritë dhe investimet që do të kryhen në zonën e bashkëmenaxhimit të liqenit të Shkodrës dhe lumit Buna të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

**VENDIM****Nr. 471, datë 23.6.2016**

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 335, DATË 2.9.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3, të vendimit nr. 335, datë 2.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen emërtimet:

- Presidenti, zëvendës-presidenti dhe sekretari i Përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit, pjesëmarrës në Kampionatin Evropian të Futbollit 2016;

- Trajneri, zëvendëstrajnerët, trajneri i portierëve dhe menaxheri i Ekipit Kombëtar të Futbollit, pjesëmarrës në Kampionatin Evropian të Futbollit 2016;

- Futbollistët e Ekipit Kombëtar të Futbollit, pjesëmarrës në Kampionatin Evropian të Futbollit 2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 3078, datë 14.6.2016**

PËR NDRYSHIMIN E UDHËZIMIT TË PËRBASHKËT NR. 1568/3, DATË 14.4.2015, “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMEVE PORTUALE NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS PËR VITIN 2015”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, nenit 84, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 22.1.2016, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

1. Ndryshimin e udhëzimit të përbashkët nr. 1568/3, datë 14.4.2015, “Për përcaktimin e Tarifave të shërbimeve portuale në Autoritetin Portual Durrës për vitin 2015”, si më poshtë:

i) Në kapitullin 1, “Tarifat e pagueshme nga pronari apo agjenti i anijes”, pika 1, “Tarifat e portit dhe kanalit”, te pika 5.1, “Përrjashtime” shtohet germa:

“f) Anijet turistike: kroçera, yahte, veliera etj. të kësaj natyre”.

ii) Në kapitullin 1, “Tarifat e pagueshme nga pronari apo agjenti i anijes”, pika 1, “Tarifat e portit dhe kanalit”, pika 1.1.1, “Tarifat e portit dhe kanalit për anije për prekje”, bëhet:

“a) Për tragete deri në 13.000 GT (T1) € /GT 0.15

Për tragete mbi 13.000 GT për çdo GT mbi 13.000 GT (T2) € /G T 0.01

b) Tarifë për çdo prekje trageti, mbi 20 prekje në muaj, për çdo kompani, për 1 (një) linjë operimi 20% zbritje

Përrjashtohen nga aplikimi i kësaj tarife “b” periudha e pikut: 15 korrik–15 shtator dhe 15 dhjetor–15 janar.

Për efekt të aplikimit të pikës “b”, “muaj” do të konsiderohet periudha nga data 15 e muajit deri 15 të muajit pasardhës.

c) Për anije të tjera përrfshirë dhe anije Ro/Ro € /GT 0.23.”.

iii) Në kapitullin 1, “Tarifat e pagueshme nga pronari apo agjenti i anijes”, pika 1.2, “Tarifat e akostimit”, pika 1.2.2, “Tarifat e Kalatës/vend-akostimit”, pika 2 ndryshohet si më poshtë:



- “2. Për anije, që qëndrojnë në port pas veprimeve tregtare €/metër linear 1.27.”.
në ditë ose pjesë të saj
- iv) Në kapitullin 2, “Tarifat e përpunimit të pagueshme nga pronari apo agjenti i anijes apo mallit”, pika 2.7, “Tarifa për përpunimin e mallrave gjenerale”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:
- “3. (Shumë të rënda) Ngarkesa të rënda dhe me përmasa të mëdha (makineri, pajisje etj., të cilat nuk përfshihen në këtë libër tarifash.) mbi 5000 kg/njësi lekë/tonë 2.100.”.
- v) Në kapitullin 2, “Tarifat e përpunimit të pagueshme nga pronari apo agjenti i anijes apo mallit”, pika 2.11, “Tarifat e përpunimit të automjeteve dhe makinave (mallra Ro/Ro), pika 3, “Shërbime për ngarkimin ose shkarkimin e mjeteve apo ngarkesave”, gjerat “c” dhe “d” ndryshohen si më poshtë:
- “c) Pagesa e një tarife sigurie për makinat, furgonat (deri, përfshirë 3.5 tonë) në të dyja mënyrat, p.sh. ngarkim ose shkarkim euro/njësi 1
- d) Pagesa e një tarife sigurie për kamionët/trailerat (mbi 3.5 tonë) të dyja mënyrat p.sh. ngarkimin ose shkarkimin euro/njësi 2.”.
2. Institucioni përgjegjës për vjeljen e tarifave është Autoriteti Portual Durrës ose subjekte të autorizuara prej tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

KËRKESË

Nr. 3491, datë 21.6.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Restaurimi dhe kthimi në identitetet i godinës së Prefekturës së Qarkut Tiranë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Prefektura e Qarkut Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 5,703,338 (pesë milionë e shtatëqind e tre mijë e treqind e tridhjetë e tetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI
I ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi



Lista e pronareve per shpronosim

Nr.	Zona kadastrale	Nr. pasurise	Adresa	Pronari	Siperfaqe Trualli	Siperfaqe Ndertimi	Çmimi truall	Çmimi ndertes	Vlera e truallit	Vlera e ndertes	Vlera truall dhe ndertese	Shenime
1	8380	3/170-N4 & 3/170/ND-N3	Tiranë	Arben Haderaj	22.3	22.3	66,969	32,113	1,493,409	716,120	2,209,529	Konfirmuar nga ZVRPP
2	8380	3/170/ND-N7	Tiranë	Enver Zhubi	24.32	24.32	66,969	32,113	1,628,686	780,988	2,409,674	Konfirmuar nga ZVRPP. Per truallin saktesim dokumentacioni
3	8380	3/170/ND-N2	Tiranë	Faruk Hyseni	0	21.6	66,969	32,113	-	693,641	693,641	Konfirmuar nga ZVRPP
4	8380	3/170/ND-N6	Tiranë	Hamdi Çeço	0	12.16	66,969	32,113	-	390,494	390,494	Konfirmuar nga ZVRPP
				Shuma:							5,703,338	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë